

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-159/13

**Prishtinë,
19 shkurt 2014**

Në çështjen juridike të

M. S.

Serbi

Pala ankuese

kundër

Nuk dihet

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Dag Brathole dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/183/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA27583), të datës 14 dhjetor 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 19 shkurt 2014, mori këtë

AKTGJYKIM

- 1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e M. S. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/183/ të datës 14 dhjetor 2012, sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin 27583.**

- 2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/183/ i datës 14 dhjetor 2012, sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin 27583.**

Përmbledhja faktike dhe procedurale

1. Më 13 shkurt 2007 M. S. ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) ku ka kërkuar të drejtën pronësore ndaj një banesë me sipërfaqe prej 78,50 m² në katin e tretë të ngastrës nr. 2049, 2051 dhe 2052 në Ferizaj. Së bashku me kërkesën, ai ka paraqitur disa dokumente tjera lidhur me pronën, duke përfshirë edhe kontratën e shitblerjes së datës 11 mars 1999.
2. Para paraqitjes së kërkesës, S. kishte paraqitur një kërkesë të njëjtë në Komisionin për Çështje Pronësore Banesore (KÇPB). Kjo kërkesë ishte hedhur poshtë dhe i ishte referuar gjykatës kompetente vendore nga ana e KÇPB-së në vendimin e tij nr. HPCC/D/189/2005/C të datës 30 prill 2005. Kërkesa për rishqyrtim ishte refuzuar nga DÇPB-ja me vendimin e saj nr. HPCC/REC/58/2006 të datës 18 shkurt 2006.
3. Më 14 dhjetor 2012, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) me vendimin e tij KPCC/D/R/183/2012, e refuzoi kërkesën. Në paragrafin 30 të vendimit grupor, i cili sipas vendimit të vërtetuar të datës 2 prill 2013, vlen posaçërisht për këtë kërkesë, theksohet se dokumentet që paraqitësi i kërkesës (S.) i kishte paraqitur, nuk ishin verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive. Sekretaria Ekzekutive po ashtu nuk ka qenë në gjendje t'i sigurojë sipas detyrës zyrtare provat që do të mbështesnin këtë kërkesë.
4. Vendimi i KKPK-së i ishte dorëzuar S. më 13 maj 2013. Më 31 maj 2013, ai e ka kundërshtuar vendimin në Kolegjin e Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme. Pasi që nuk është regjistruar asnjë palë përgjegjëse, nuk ka palë përgjegjëse në ankesë në këtë rast. Gjykata Supreme e ka pranuar dosjen e lëndës më 28 janar 2014.

Pretendimet e palës ankuese

5. M. S. pretendon se KKPK-ja i ka vërtetuar në mënyrë të gabuar faktet dhe se ka bërë zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.
6. AKP-ja ka deklaruar se Sekretaria Ekzekutive nuk ka mundur të verifikojë ndonjë prej dokumenteve të bashkëngjitura në kërkesë. S. pretendon se organet dhe dokumentet ekzistojnë dhe ato mund të konfirmojnë vërtetësinë e pretendimeve të tija. Ai thekson se pohimi i bërë nga KKPK-ja, i cili është pa raporte konkrete për verifikim, është i papranueshëm.
7. Në ankesë, S. jep një prezantim të hollësishëm të dokumenteve që i kishte dorëzuar me qëllim të konfirmimit të pronësisë së tij. Ai deklaron se e tërë procedura e fitimit të pronësisë ishte në përputhje me dispozitat ligjor dhe se asnjë pjesë e procesit nuk ishte diskriminuese kundër ndokujt. Më në fund, S. i referohet nenit 8 dhe 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njëritut dhe nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

Arsyetimi ligjor

8. Ankesa është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh siç parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (*këtej e tutje Ligji nr. 03/L-079*) dhe është e pranueshme.
9. KPK-ja e ka bazuar vendimin e vet në faktin se AKP-ja dhe Sekretaria Ekzekutive e KKPK-së kishin bërë një verifikim negativ të dokumenteve në të cilat S. e bazon kërkesën e tij pronësore, duke përfshirë kontratën e qiradhënies të datës 15 mars 1999, kontratën për shitblerjen e banesës të datës 11 mars 1999 dhe konfirmimin e Gjykatës Komunale të Ferizajt të datës 15 mars 1999. Sekretaria Ekzekutive nuk ka qenë në gjendje që të sigurojë sipas detyrës zyrtare ndonjë provë që do të mbështeste kërkesën e S. Në bazë të kësaj, KKPK-ja kishte vërtetuar se S. nuk kishte arritur të dëshmojë ndonjë të drejtë pronësore ndaj pronës kontestuese.
10. Gjykata Supreme vëren se Komisioni për Çështje Pronësore Banesore e kishte hedhur poshtë kërkesën e S. me vendimin HPCC/D/189/2005/C të datës 30 prill 2005, dhe e kishte refuzuar edhe kërkesën e tij për rishqyrtim të vendimit HPCC/REC/58/2006 të datës 18 shkurt 2006.
11. Ankesa e S përsërit të njëjtat pretendime të bërë në KKPK. Asnjë provë e re e rëndësishme nuk është paraqitur me ankesë.
12. Gjykata Supreme gjen se KKPK-ja ka marrë vendim të drejtë duke vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike dhe duke zbatuar drejtë të drejtën materiale, në bazë të një procedurë tërësore dhe korrekte. Prandaj, Gjykata Supreme vërteton se nuk ka pasur shkelje të Konventës

Evropiane për të Drejtat e Njeriut apo të Kushtetutës së Kosovës. Gjykata Supreme gjen se ankesa është e pabazuar.

13. Duke marrë parasysh atë që u cek më lartë, në pajtim me nenin 13.3 nën pikën (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë juridike

14. Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjete të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridik.

Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Dag Brathole, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it